

URDHËR
Nr. 634, datë 2.11.2023

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR LËVIZJEN JOTREGTARE TË
KAFSHËVE TË SHOQËRIMIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, pika 6 e nenit 33, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe pikës 2, të kreut III, të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 475, datë 30.7.2021, “Për bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes vendore me Shërbimin Veterinar”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores “Për lëvizjen jotregtare të kafshëve të shoqërimit”, sipas tekstit të këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
 2. Urdhri i ministrit nr. 353, datë 18.12.2012, “Për kërkesat e shëndetit të kafshëve të aplikuara për lëvizjet jokomerciale të kafshëve shtëpiake” dhe urdhri i ministrit nr. 219, datë 14.4.2016, “Për modelin e pasaportës për lëvizjen e qenve dhe maceve në territorin e Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.
 3. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.
- Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

RREGULLORE
PËR LËVIZJEN JOTREGTARE TË KAFSHËVE TË SHOQËRIMIT

KAPITULLI I

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton kërkesat shëndetësore të kafshëve të shoqërimit që zbatohen për lëvizjen jotregtare të kafshëve të shoqërimit dhe rregullat për kontrollet e një lëvizjeje të tillë.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për lëvizjen jotregtare të kafshëve të shoqërimit nga një shtet ose territor tjetër drejt territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Kjo rregullore zbatohet pa rënë ndesh me:
 - a) legjislacionin në fuqi në lidhje me mbrojtjen e florës dhe faunës së egër;
 - b) çdo masë të miratuar nga SPV, publikuar dhe vënë në dispozicion të publikut për të kufizuar lëvizjen e llojeve të caktuara ose racave të kafshëve të shoqërimit në bazë të legjislacionit në fuqi që lidhet me shëndetin e kafshëve.

Neni 3
Përkufizime

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:
 - a) “lëvizje jotregtare” është çdo lëvizje që nuk ka për qëllim as shitjen ose transferimin e pronësisë së një kafshe të shoqërimit;
 - b) “kafshë shoqërimi” është një kafshë e një specie të renditur në aneksin 1 që shoqëron pronarin e saj ose një person të autorizuar, gjatë lëvizjes jotregtare dhe e cila mbetet për kohëzgjatjen e kësaj lëvizjeje jotregtare nën përgjegjësinë e pronarit ose personit të autorizuar;
 - c) “pronar” nënkupton një individ, i përcaktuar si pronar në dokumentin e identifikimit;
 - ç) “person i autorizuar” nënkupton çdo individ që ka autorizim me shkrim nga pronari për të kryer lëvizjen jokomerciale të kafshës së shoqërimit në emër të pronarit;
 - d) “transponder” nënkupton një pajisje identifikuese për leximin pasiv me radiofrekuencë;
 - dh) “dokument identifikimi” është një dokument i hartuar dhe miratuar në përputhje me këtë rregullore, që lejon që kafsha e shoqërimit të identifikohet qartësisht dhe gjendja shëndetësore të kontrollohet në përputhje me këtë rregullore;
 - e) “mjek veterinar i autorizuar” nënkupton çdo veterinar i cili është autorizuar nga autoriteti kompetent pas miratimit nga trupa statusore veterinare, për të kryer një ose disa detyra të veterinerit zyrtar apo për të kryer detyra specifike në përputhje me këtë rregullore ose me aktet e miratuara në përputhje me këtë rregullore;
 - ë) “veterinar zyrtar” nënkupton çdo veterinar siç përcaktohet në pikën 127, të nenit 4, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
 - f) “kontroll dokumentar” nënkupton verifikimin e dokumentit të identifikimit që shoqëron kafshën e shoqërimit;
 - g) “kontroll identiteti” do të thotë verifikim për përputhshmërinë midis dokumentit të identifikimit dhe kafshës së shoqërimit dhe sipas rastit për praninë dhe konformitetin e identifikimit;
 - gj) “pika e hyrjes së udhëtarëve” nënkupton çdo zonë që shërben për kryerjen e kontrollit të inspektimeve veterinare të lëvizjes jokomerciale të kafshëve të shoqërimit.

Neni 4

Detyrim i përgjithshëm

Lëvizja jotregtare e kafshëve të shoqërimit që kryhet në përputhje me kërkesat për shëndetin e kafshëve, të përcaktuara në këtë rregullore nuk do të ndalohet, kufizohet ose pengohet për arsye shëndetësore, të ndryshme nga ato që rezultojnë nga zbatimi i kësaj rregulloreje.

Neni 5

Numri maksimal i kafshëve të shoqërimit

1. Numri maksimal i kafshëve të shoqërimit të specieve të listuara në pjesën A, të shtojcës 1 që shoqërojnë pronarin ose një person të autorizuar gjatë një lëvizjeje të vetme jotregtare nuk duhet të kalojë numrin 5 (pesë).
2. Me përjashtim të pikës 1, numri maksimal i kafshëve shtëpiake të llojeve të listuara në pjesën A, të aneksit 1 mund të kalojë numrin 5 (pesë) nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - a) lëvizja jotregtare e kafshëve të shoqërimit është me qëllim pjesëmarrjen në gara, ekspozita ose aktivitete sportive ose në trajnime për aktivitete të tilla;
 - b) pronari ose personi i autorizuar paraqet dëshmi me shkrim se kafshët e shoqërimit janë regjistruar për të marrë pjesë në një nga aktivitetet e përmendura në germën (a), ose në një shoqatë që organizon aktivitete të tilla;
 - c) kafshët e shoqërimit janë më shumë se gjashtë muajsh.
3. Autoriteti kompetent duhet të ndërmarrë kontrolle standarde në vend, për të verifikuar nëse informacioni i paraqitur sipas germës “b”, të pikës 2 të këtij neni është i saktë.

4. Në rast se nuk plotësohen kërkesat e përmendura në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, për kafshët e shoqërimit për qëllim jotregtar do të zbatohen kërkesat për shëndetin e kafshëve të përcaktuara në rregullat e importit për speciet në fjalë dhe autoriteti kompetent duhet të sigurojë që këto kafshë t'i nënshtrohen kontrolleve veterinarë siç përcaktohet në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, sipas rastit.

KAPITULLI II

KUSHTET E ZBATUESHME PËR LËVIZJEN JOTREGTARE TË KAFSHËVE TË SHOQËRIMIT NGA NJË TERRITOR OSE SHTET TJETËR

SEKSIONI 1

Kafshët e shoqërimit të llojeve të listuara në pjesën A, të shtojcës I

Neni 6

Kushtet e zbatueshme për lëvizjen jotregtare të kafshëve të shoqërimit të llojeve të listuara në pjesën A, të shtojcës I

1. Kafshët e shoqërimit të llojeve të listuara në pjesën A, të shtojcës I, të kësaj rregulloreje, futen në territorin e Republikës së Shqipërisë, kur plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) ato janë të identifikuar nga implantimi i transponderit ose nga një tatuazh i lexueshëm, në përputhje me nenin 11, pika 1;
- b) ato kanë marrë një vaksinë kundër tërbimit që përputhet me kërkesat e vlefshmërisë të përcaktuara në shtojcën III;
- c) ato i janë nënshtrohur testit të titrimit të antittrupave ndaj sëmundjes së tërbimit që është në përputhje me kërkesat e vlefshmërisë të përcaktuara në shtojcën IV;
- ç) ato janë në përputhje me masat shëndetësore parandaluese për sëmundje ose infeksione të tjera ndaj tërbimit, në përputhje me pikën 1, të nenit 13;
- d) ato janë të shoqëruar nga një dokument identifikimi, i plotësuar dhe i lëshuar në përputhje me nenin 18.

2. Kafshët e shoqërimit të llojeve të listuara në pjesën A, të shtojcës 1 që hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga një vend ose territor tjetër nga ata të listuar në përputhje me nenin 9, pika 1, vetëm nëpërmjet pikave të përcaktuara hyrëse të udhëtarëve.

3. Me përjashtim të pikës 2 të këtij neni, Autoriteti Kompetent autorizon qentë e regjistruar ushtarakë ose të kërkim-shpëtimit për të lëvizur nëpërmjet një pike hyrjeje të ndryshme nga pika e hyrjes së udhëtarëve me kusht që:

- a) pronari ose personi i autorizuar ka aplikuar paraprakisht për një leje tek autoriteti kompetent dhe i është dhënë një leje e tillë; dhe
- b) qentë u nënshtrohen kontrolleve të pajtueshmërisë në përputhje me nenin 23, pika 2, në një vend të përcaktuar për këtë qëllim dhe në përputhje me masat e përcaktuara në lejen e përmendur në germën "a" të kësaj pike.

Neni 7

Përjashtimi nga kushti i vaksinimit kundër tërbimit për kafshët e reja të shoqërimit, të llojeve të listuara në pjesën A, të shtojcës I

1. Në përjashtim të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 6, SPV autorizon lëvizjen jotregtare në territorin e Republikës së Shqipërisë nga një territor ose shtet tjetër, sipas përcaktimeve të nenit 9, pika 1 ose 2, vetëm për kafshët e shoqërimit, të specieve të listuara në pjesën A, të shtojcës 1, të cilat janë:

- a) ose më pak se 12 javë dhe nuk kanë marrë një vaksinë kundër sëmundjes së tërbimit; ose

b) midis 12 dhe 16 javësh dhe kanë marrë një vaksinë kundër sëmundjes së tërbimit, por nuk plotësojnë ende kërkesat e vlefshmërisë të përmendura në shkronjën “e”, të pikës 2, të shtojcës III.

2. Autorizimi i përmendur në pikën 1 jepet vetëm nëse:

a) pronari ose personi i autorizuar jep një deklaratë të nënshkruar që nga lindja deri në kohën e lëvizjes jotregtare të kafshëve të shoqërimit që nuk kanë pasur kontakt me kafshë të egra të specieve të ndjeshme ndaj sëmundjes së tërbimit; ose

b) kafshët e shoqërimit shoqërohen nga nëna e tyre nga e cila ato varen akoma, dhe nga dokumenti i identifikimit që shoqëron nënën e tyre që vërteton se para lindjes së tyre nëna ka marrë një vaksinë kundër sëmundjes së tërbimit e cila është në përputhje me kërkesat e vlefshmërisë të përcaktuara në shtojcën III;

c) formati dhe gjuha e deklaratës sipas shkronjës “a”, të pikës 2 të këtij neni, përcaktohet në shtojcën V, pjesa 1 e këtij urdhri.

Neni 8

Përfshirja nga kushti i vaksinimit kundër tërbimit për kafshët e shoqërimit të llojeve të listuara në pjesën A, të shtojcës I

1. Në përfshirje të shkronjës “c”, pika 1 e nenit 6, testi i titrimit të antitropave nuk duhet të kërkojë për kafshët e shoqërimit të llojeve të listuara në pjesën A, të shtojcës 1, që hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga një vend tjetër i listuar në përputhje me nenin 9, pika 1 ose 2:

a) drejtpërdrejt; ose

b) që janë rezidentë ekskluzivisht në një ose më shumë prej këtyre vendeve; ose

c) pas tranzitit përmes një vendi të ndryshëm nga ato të listuara në përputhje me pikën 1 dhe 2, të nenit 9, me kusht që pronari ose personi i autorizuar të japë një deklaratë të nënshkruar, që gjatë tranzitit kafshët e shoqërimit nuk kanë pasur kontakt me kafshët e speciet e ndjeshme ndaj tërbimit dhe mbeten të siguruara brenda një mjeti transporti ose brenda perimetrit të një aeroporti ndërkombëtar;

ç) formati dhe gjuha e deklaratës sipas shkronjës “c”, të pikës 1 të këtij neni, përcaktohet në shtojcën V, pjesa 2 e këtij urdhri.

Neni 9

Krijimi i listës së territoreve dhe vendeve të tjera

1. Lista e vendeve që përcakton kafshët e shoqërimit të llojeve të listuara në pjesën A, të shtojcës 1, jepet në pjesën 1, të aneksit 6 të kësaj rregulloreje. Këto vende zbatohen të njëjtat rregulla me ato të përcaktuara në seksionin 1 dhe 2, të kapitullit V, të kësaj rregulloreje.

2. Lista e vendeve që përcakton kafshët e shoqërimit të llojeve të listuara në pjesën A, të shtojcës 1, jepet në pjesën 2, të shtojcës VI, të kësaj rregulloreje. Këto vende duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) detyrimin për të njoftuar rastet e tërbimit tek autoriteti kompetent;

b) të kenë vendosur dy vjet përpara aplikimit një sistem efektiv mbikëqyrjeje për zbulimin e hershëm dhe raportimin e kafshëve të dyshuara për tërbim;

c) struktura, kompetencat, organizimi i shërbimeve veterinarë dhe të kontrollit, si dhe mbikëqyrja dhe mjetet në dispozicion të tyre, ku përfshihet stafi dhe kapaciteti laboratorik, të mjaftueshme për:

i. zbatimin dhe hyrjen në fuqi në mënyrë efektive të legjislacionit kombëtar për lëvizjen jotregtare të kafshëve të shoqërimit; dhe

ii. vlefshmërinë e dokumenteve të identifikimit në formatin e parashikuar në nenin 17 dhe të lëshuara në përputhje me nenin 18 të kësaj rregulloreje;

ç) rregullat për parandalimin dhe kontrollin e tërbimit zbatohen në mënyrë efektive për të minimizuar rrezikun e infektimit të kafshëve shtëpiake, duke përfshirë rregullat për importet e kafshëve të shoqërimit nga vende ose territore të tjera, dhe kur është e përshtatshme, për:

- i. kontrollin e popullatës së qenve dhe maceve endacakë;
- ii. vaksinimi i kafshëve të shoqërimit kundër tërbimit, veçanërisht kur tërbimi është i pranishëm te lakuriqët e natës; dhe
- iii. kontrollin dhe çrrënjosjen e tërbimit në kafshët e egra;

d) rregullat për licencimin dhe tregtimin e vaksinave kundër tërbimit.

3. Mbi arsye të justifikuara dhe të rëndësishme, urgjente në lidhje me rreziqet për shëndetin publik ose të kafshëve, me propozimin e SPV-së, ministri përditëson listën e territoreve ose vendeve të tjera të përmendura në pikën 1 dhe 2 të këtij neni.

SEKSIONI 2

Kafshët e shoqërimit të llojeve të listuara në pjesën B, të shtojcës I

Neni 10

Kushtet e zbatueshme për lëvizjen jotregtare të kafshëve të shoqërimit të llojeve të listuara në pjesën B, të shtojcës I

1. Kafshët e shoqërimit të llojeve të listuara në pjesën B, të shtojcës 1, hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga një territor apo shtet tjetër vetëm nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) ato janë identifikuar ose përshkruar sipas kërkesave të miratuara në përputhje me pikën 2, të nenit 11;

b) ato janë në përputhje me çdo masë parandaluese shëndetësore për sëmundje ose infeksione të ndryshme nga tërbimi, në përputhje me nenin 13;

c) ato shoqërohen nga një dokument identifikimi i plotësuar dhe lëshuar siç duhet në përputhje me nenin 20;

ç) ato hyjnë përmes një pike hyrëse të udhëtarëve kur vijnë nga një territor ose një vend tjetër.

2. Autoriteti kompetent zbaton masa shtesë për lëvizjen jotregtare të kafshëve të shoqërimit të specieve të listuara në pjesën B, të shtojcës 1, në territorin e Republikës së Shqipërisë nga një vend tjetër, me kusht që këto rregulla të jenë:

a) të zbatueshme në mënyrë proporcionale ndaj rrezikut për shëndetin publik ose të kafshëve që lidhet me lëvizjen jotregtare të kafshëve të shoqërimit të atyre specieve;

b) pa rënë ndesh dhe jo më të rrepta se ato të zbatuara për importet e kafshëve të atyre specieve në përputhje me ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

KAPITULLI III

IDENTIFIKIMI DHE MASAT SHËNDETËSORE PARANDALUESE

SEKSIONI 1

Identifikimi

Neni 11

Identifikimi i kafshëve të shoqërimit

1. Kafshët e shoqërimit të llojeve të listuara në pjesën A, të shtojcës I, identifikohen nga vendosja e një transponderi ose nga një tatuazh qartësisht i lexueshëm. Kur transponderi nuk përputhet me kërkesat teknike të përcaktuara në shtojcën 2, pronari ose personi i autorizuar duhet të sigurojë mjetet e nevojshme për leximin e transponderit në momentin e çdo verifikimi

identifikues të parashikuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 15, nenit 18, kontrollet e identitetit të parashikuara në pikën 1 të nenit 22 dhe nenit 23.

2. Kafshët e shoqërimit të llojeve të listuara në pjesën B, të shtojcës I, do të identifikohen duke marrë parasysh specifikat e çdo specieje, në mënyrë të tillë që të sigurohet një lidhje midis kafshës së shoqërimit dhe dokumentit përkatës të identifikimit të saj.

Duke pasur parasysh diversitetin e llojeve të listuara në pjesën B, të shtojcës I, me propozimin e SPV-së, ministri miraton kërkesat specifike për speciet për identifikimin ose përshkrimin e kafshëve të shoqërimit të atyre specieve, duke marrë parasysh çdo kërkesë kombëtare të rëndësishme.

Neni 12

Vendosja e transponderave në kafshët e shoqërimit

Në rastet kur transponderët vendosen nga një person/subjekt i ndryshëm nga mjeku veterinar i autorizuar, duhet të ketë kualifikimet minimale që kërkojnë.

SEKSIONI 2

Masat profilaktike shëndetësore për sëmundje apo infeksione të tjera nga tërbimi

Neni 13

Masat profilaktike shëndetësore dhe kushtet për zbatimin e tyre

1. Kur masat profilaktike shëndetësore janë të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit publik ose të shëndetit të kafshëve të shoqërimit me qëllim kontrollin e sëmundjeve ose infeksioneve të ndryshme nga sëmundja e tërbimit, që rrezikojnë përhapjen për shkak të lëvizjes së këtyre kafshëve të shoqërimit, zbatohen masat shtesë të kontrollit të vendosura sipas pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Masat shëndetësore profilaktike specifike për speciet, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, bazohen në informacionin e duhur, të besueshëm dhe të vlefshëm shkencor dhe zbatohen në mënyrë proporcionale me rrezikun për shëndetin publik ose të kafshëve që lidhen me lëvizjen jotregtare të kafshëve të shoqërimit që mund të preken nga sëmundje ose infeksione të tjera përveç tërbimit.

KAPITULLI IV

DOKUMENTET E IDENTIFIKIMIT

SEKSIONI 1

Dokumentet e identifikimit për lëvizjen jotregtare të kafshëve të shoqërimit të specieve të listuara në pjesën A, të shtojcës I

Neni 14

Formati dhe përmbajtja e dokumentit të identifikimit – pasaporta

1. Dokumenti i identifikimit për hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të jetë në formatin e një pasaporte në përputhje me modelin e përcaktuar në shtojcën VII, pjesa 1 dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) vendndodhjen e transponderit ose tatuazhit dhe/ose datën e aplikimit ose datën e leximit të transponderit ose tatuazhit, si dhe kodin alfanumerik të shfaqur nga transponderi ose tatuazhi;

b) emri, specia, raca, gjinia, ngjyra, data e lindjes siç deklarohet nga pronari dhe çdo veçori ose karakteristika të dukshme ose të dallueshme të kafshës së shoqërimit;

- c) emri dhe informacionin e kontaktit të pronarit;
 - ç) emri, informacionin e kontaktit dhe nënshkrimin e mjekut veterinar privat/autorizuar që lëshon ose plotëson dokumentin e identifikimit;
 - d) nënshkrimin e pronarit;
 - dh) detajet e vaksinimit kundër tërbimit;
 - e) datën e marrjes së mostrave të gjakut për testin e titrimit të antitrapave të tërbimit;
 - ë) pajtueshmërinë me çdo masë shëndetësore parandaluese për sëmundje ose infeksione të ndryshme nga tërbimi;
 - f) informacione të tjera të rëndësishme në lidhje me gjendjen shëndetësore të kafshës së shoqërimit.
2. Format i pasaportës, i përcaktuar në pikën 1, si dhe kërkesat në lidhje me gjuhën, paraqitjen dhe veçoritë e sigurisë së pasaportës, si dhe rregullat e nevojshme për kalimin në modelin e asaj pasaporte jepen në shtojcën VII, pjesa 2 e kësaj rregulloreje.
3. Pasaporta e përmendur në pikën 1 të këtij neni duhet të ketë një numër që përbëhet nga kodi ISO i vendit i ndjekur nga një kod unik alfanumerik.

Neni 15

Lëshimi dhe plotësimi i dokumentit të identifikimit – pasaporta

1. Dokumenti i identifikimit i përmendur në nenin 14 lëshohet nga një mjek veterinar privat/i autorizuar pasi:
- a) ai ka verifikuar që kafsha e shoqërimit është e identifikuar në përputhje me nenin 11, pika 1;
 - b) ai ka plotësuar siç duhet shënimet përkatëse në dokumentin e identifikimit me informacionin e përmendur në gjerat “a” deri “d”, në pikën 1, të nenit 14; dhe
 - c) pronari ka nënshkruar dokumentin e identifikimit.
2. Pas verifikimit që kafsha shtëpiake është e identifikuar në përputhje me pikën 1, të nenit 11, një mjek veterinar i autorizuar plotëson shënimet përkatëse të dokumentit të identifikimit me informacionin e përmendur në gjerat “d”, “f”, “g” dhe “h”, pika 1, e nenit 14.
3. Mjeku veterinar i autorizuar që lëshon dokumentin e identifikimit do të mbajë shënime të informacionit të përmendur në gjerat “a” deri në “c”, pika 1 e nenit 14, dhe pika 3, e nenit 14, për një periudhë minimale që do të përcaktohet nga SPV, por që nuk duhet të jetë më pak se tre vjet.
4. Në rastet e mospërputhshmërisë me kushtet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, përrputhshmëria duhet të dokumentohet në një dokument të ri identifikimi në formatin e parashikuar në nenin 14, pika 1.

Neni 16

Shpërndarja e dokumenteve të identifikimit bosh

1. Autoriteti kompetent duhet të sigurojë që dokumentet bosh të identifikimit t'i shpërndahen vetëm mjekëve veterinarë privatë/të autorizuar dhe se emri i tyre dhe informacioni i kontaktit të regjistrohën duke iu referuar numrit të përmendur në nenin 20.
2. Të dhënat e përmendura në pikën 1 të këtij neni duhet të mbahen për një periudhë minimale që nuk duhet të jetë më pak se tre vjet.

SEKSIONI 2

Dokumentet e identifikimit për lëvizjen jotregtare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nga një shtet tjetër i kafshëve të shoqërimit të llojeve të listuara në pjesën A, të shtojcës I

Neni 17

Formati dhe përmbajtja e certifikatës shëndetësore

1. Dokumenti i identifikimit i përmendur në germën “e”, pika 1, e nenit 6, për lëvizjen jotregtare të kafshëve të shoqërimit të llojeve të listuara në pjesën A, të shtojcës I, do të jetë në formatin e një certifikate shëndetësore të kafshëve në përputhje me modelin e përcaktuar në shtojcën VIII të kësaj rregulloreje dhe duhet të ketë informacionin e mëposhtëm:

a) vendndodhjen e transponderit ose tatuazhit dhe ose datën e aplikimit ose datën e leximit të transponderit ose tatuazhit, si dhe kodin alfanumerik të shfaqur nga transponderi ose tatuazhi;

b) specia, raca, data e lindjes siç deklarohet nga pronari, gjininë dhe ngjyrën e kafshës shtëpiake;

c) një numër unik reference certifikate;

ç) emrin dhe informacionin e kontaktit të pronarit ose personit të autorizuar;

d) emri, informacioni i kontaktit dhe nënshkrimi i veterinerit zyrtar ose të autorizuar që lëshon dokumentin e identifikimit;

dh) detajet e vaksinimit kundër tërbimit;

e) datën e marrjes së mostrave të gjakut për testin e titrimit të antitrapave të tërbimit;

ë) pajtueshmërinë me çdo masë shëndetësore parandaluese për sëmundje ose infeksione të ndryshme nga tërbimi;

f) emrin dhe nënshkrimin e veterinerit zyrtar miratues të certifikatës;

g) emri, nënshkrimi dhe informacioni i kontaktit të përfaqësuesit të autoritetit kompetent që kryen kontrollin e përmendur në nenin 23 dhe datën e këtyre kontrolleve;

gj) informacione të tjera të rëndësishme në lidhje me gjendjen shëndetësore të kafshës së shoqërimit.

2. Modeli i përmendur në pikën 1 të këtij neni, si dhe kërkesat në lidhje me gjuhën, paraqitjen dhe vlefshmërinë e certifikatës së shëndetit të kafshëve jepen në shtojcën VIII, pjesa 1 e kësaj rregulloreje.

3. Shënimet shpjeguese për plotësimin e certifikatës së shëndetit të kafshëve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, jepen në shtojcën 8, pjesa 2 e kësaj rregulloreje. Pjesë e dokumentit të identifikimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni duhet të jetë një deklaratë me shkrim e nënshkruar nga pronari ose personi i autorizuar që vërteton se lëvizja e kafshëve të shoqërimit në Republikën e Shqipërisë është një lëvizje jotregtare.

4. Modeli i deklaratës të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, jepet në shtojcën 8, pjesa 3 e kësaj rregulloreje.

Neni 18

Lëshimi dhe plotësimi i certifikatës shëndetësore të kafshëve të shoqërimit

Certifikata shëndetësore e kafshëve të shoqërimit që përcaktohet në nenin 17 miratohet nga Autoriteti Kompetent i territorit ose i vendit të origjinës dhe lëshohet nga një veteriner zyrtar i territorit ose vendit të origjinës në bazë të dokumentacionit mbështetës, ose nga një veteriner i autorizuar, pasi veterineri zyrtar ose i autorizuar:

a) ka verifikuar që kafsha e shoqërimit është e identifikuar në përputhje me pikën 1 nenin 11; dhe

b) ka plotësuar saktë shënimet përkatëse të dokumentit të identifikimit me informacionin e përmendur në shkronjat “a” deri në “gj”, pika 1 e nenit 17, duke respektuar kushtet e përcaktuara në germën “a”, pika 1 e nenit 6, dhe aty ku është e zbatueshme germat “b”, “c” dhe “d”, pika 1 e nenit 6.

SEKSIONI 3

Dokumentet e identifikimit për lëvizjen jotregtare të kafshëve shtëpiake nga një shtet tjetër për në Republikën e Shqipërisë e llojeve të listuara në pjesën B, të shtojcës I

Neni 19

Formati dhe përmbajtja e dokumentit të identifikimit të kafshëve të shoqërimit për llojet e listuara në pjesën B, të shtojcës I

1. Modeli i dokumentit të identifikimit, i përcaktuar në shkronjën “c”, pika 2 të nenit 10, për kafshët e shoqërimit të listuara në pjesën B, të shtojcës I, duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- a) karakteristikat e shenjave ose përshkrimin e kafshës së shoqërimit siç parashikohet në pikën 2, të nenit 11;
- b) lloji i kafshës dhe sipas rastit, raca, data e lindjes siç është deklaruar nga pronari, gjinia dhe ngjyra e kafshës së shoqërimit;
- c) emri dhe informacionin e kontaktit të pronarit ose personit të autorizuar;
- ç) emri, informacioni i kontaktit dhe nënshkrimin e veterinerit zyrtar ose të autorizuar;
- d) numri unik i referencës së certifikatës;
- dh) detajet e çdo mase parandaluese shëndetësore për sëmundje ose infeksione të ndryshme nga tërbimi;
- e) emri, nënshkrimi dhe informacioni i kontaktit të përfaqësuesit të autoritetit kompetent që kryen kontrollet e përmendura në nenin 23 dhe datën e këtyre kontrolleve;
- ë) informacione të tjera në lidhje me gjendjen shëndetësore të kafshës së shoqërimit.

Neni 20

Lëshimi dhe plotësimi i dokumentit të identifikimit për kafshët e shoqërimit të llojeve të listuara në pjesën B, të shtojcës I

1. Dokumenti i identifikimit i përmendur në shkronjën “c”, pika 2, të nenit 10, miratohet nga Autoriteti Kompetent i vendit të origjinës dhe lëshohet ose nga një veteriner zyrtar i vendit të origjinës në bazë të dokumentacionit mbështetës, ose nga një veteriner i autorizuar, pasi veterineri zyrtar ose i autorizuar:

- a) ka verifikuar që kafsha e shoqërimit është e identifikuar ose përshkruar në përputhje me nenin 11, pika 2;
- b) ka plotësuar siç duhet informacionin përkatës të dokumentit të identifikimit me informacionin e përmendur në shkronjat “a” deri në “ë”, pika 1 e nenit 19, duke vërtetuar kështu respektimin e kushteve të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të nenit 10, aty ku është e zbatueshme.

**KAPITULLI V
DISPOZITA TË PËRBASHKËTA**

SEKSIONI 1

Përfashtimet për lëvizjen jotregtare të kafshëve të shoqërimit

Neni 21

Përfashtimet nga kërkesat e neneve 6 dhe 10

1. SPV, autorizon lëvizjen jotregtare në territorin e Republikës së Shqipërisë të kafshëve të shoqërimit që nuk përmbushin kushtet e përcaktuara në nenet 6 dhe 10, në rastet kur konstatohet se:

a) është bërë një aplikim paraprak për lejen jotregtare të lëvizjes nga pronari dhe Autoriteti Kompetent ka miratuar dhënien e lejes;

b) kafsha shtëpiake është izoluar nën mbikëqyrjen zyrtare për një periudhë të nevojshme për përmbushjen e kushteve por jo më shumë se gjashtë muaj:

i. në një vend të miratuar nga Autoriteti Kompetent; dhe

ii. në përputhje me masat e përcaktuara në leje.

SEKSIONI 2

Plotësimi i kushteve të përgjithshme

Neni 22

Kryerja e kontrollit për lëvizjen jotregtare të kafshëve të shoqërimit nga shtetet e listuara në pikën 1, të nenit 9

1. Autoriteti Kompetent, për kafshët e shoqërimit që janë subjekt i lëvizjes jotregtare në Republikën e Shqipërisë nga një territor ose një vend i listuar në pikën 1, të nenit 9, kryen kontroll të dokumentacionit dhe verifikon identitetin në mënyrë jodiskriminuese.

2. Gjatë lëvizjes jotregtare në Republikën e Shqipërisë nga një territor ose një vend i listuar në pikën 1, të nenit 9, pronari ose personi i autorizuar, me kërkesë të Autoritetit Kompetent përgjegjës për kontrollin duhet:

a) të paraqesë dokumentin e identifikimit të kafshës së shoqërimit të kërkuar sipas kësaj rregulloreje, i cili demonstroi pajtueshmërinë me kërkesat për një lëvizje të tillë; dhe

b) vë në dispozicion kafshën e shoqërimit për ato kontrole.

Neni 23

Kontrollet dokumentare dhe të identitetit që duhet të kryhen në lidhje me lëvizjen jotregtare nga një vend i ndryshëm nga ato të listuara në pikën 1, të nenit 9

1. Autoriteti Kompetent, për të verifikuar nëse plotësohen kushtet e kërkuara në kapitullin II, kryen kontrole dokumentare dhe identiteti në pikën e hyrjes së udhëtarëve për kafshët shtëpiake që janë subjekt i lëvizjes jotregtare në Republikën e Shqipërisë nga një vend i ndryshëm nga ato të listuar në pikën 1, të nenit 9.

2. Pronari ose personi i autorizuar në momentin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë nga një territor ose një vend tjetër nga ai i listuar në pikën 1, të nenit 9, paraqet pranë Autoritetit Kompetent për kryerjen e kontrollit në pikën e hyrjes:

a) dokumentin e identifikimit të kafshës së shoqërimit të kërkuar sipas kësaj rregulloreje, i cili demonstroi pajtueshmërinë me kërkesat për një lëvizje të tillë; dhe

b) vë në dispozicion kafshën e shoqërimit që i nënshtrohet kontrollit.

3. Autoriteti Kompetent mban të përditësuar një listë të pikave të hyrjes së kafshëve të shoqërimit të shoqëruar nga pronari ose personi i autorizuar.

4. Autoriteti Kompetent që kryen kontrollin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni:

a) është plotësisht i informuar për rregullat e përcaktuara në kapitullin III dhe zyrtarët e autoritetit kompetent kanë trajnimin e nevojshëm për zbatimin e tyre;

b) mban shënime për numrin total të kontrolleve që janë kryer dhe për rastet e mospërputhshmërisë të zbuluara gjatë këtyre kontrolleve; dhe

c) dokumenton kontrollet që janë kryer dhe lëshon dokumentin përkatës të kontrollit të kryer, kur një dokumentacion i tillë është i nevojshëm për qëllime të lëvizjes jotregtare.

Neni 24

Masat e marra në rastet e mospërputhshmërive të gjetura gjatë kontrolleve

1. Kur nga kontrollet e kryera sipas nenit 22 dhe 23 konfirmohet se një kafshë shoqërimi nuk përmbush kushtet e përcaktuara në kapitullin II, Autoriteti Kompetent pas konsultimit me veterinerin zyrtar dhe kur është e nevojshme me pronarin ose personin e autorizuar vendos:

- a) të kthejë kafshën e shoqërimit në vendin ose territorin e origjinës;
- b) të izolojë kafshën e shoqërimit nën kontrollin zyrtar për kohën e nevojshme që ajo të përmbushë kushtet e përcaktuara në kapitullin II ose kapitullin III; ose
- c) si mjet i fundit, kur kthimi i kafshëve të shoqërimit nuk është i mundur ose izolimi nuk është praktik, kryhet eliminimi i kafshës së shoqërimit nëpërmjet eutanazisë në përputhje me rregullat kombëtare të zbatueshme për mbrojtjen e kafshëve të shoqërimit.

2. Kur lëvizja jotregtare e kafshës të shoqërimit për në Republikën e Shqipërisë refuzohet nga Autoriteti Kompetent, kafsha e shoqërimit duhet të izohet nën kontrollin zyrtar në pritje të:

- a) kthimit të tyre në vendin ose territorin e tyre të origjinës; ose
- b) miratimit të çdo vendimi tjetër administrativ në lidhje me ato kafshë shoqërimi sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Masat në përputhje me pikën 1 dhe 2 të këtij neni do të mbulohen me shpenzimet e pronarit ose personit të autorizuar.

Neni 25

Masat mbrojtëse

1. Kur tërbimi ose një sëmundje/një infeksion i ndryshëm nga tërbimi shfaqet ose përhapet në një rajon, territor ose vend tjetër ku mund të përbëjë një kërcënim serioz për shëndetin publik ose të kafshëve dhe sëmundja në fjalë është lajmëruar në OIE dhe ADIS, me propozimin e SPV, ministri miraton me urdhër një nga masat e mëposhtme, pa vonesë dhe në varësi të rëndësisë së situatës:

- a) të pezullojë lëvizjen ose tranzitin jotregtar të kafshëve të shoqërimit nga e gjitha ose një pjesë e shtetit të origjinës;
- b) të përcaktojë kushte të veçanta në lidhje me lëvizjen jotregtare të kafshëve të shoqërimit nga e gjitha ose një pjesë e shtetit në fjalë.

Neni 26

Detyrimet e informimit

1. SPV duhet t'i sigurojë publikut informacion të qartë dhe lehtësisht të aksesueshëm në lidhje me kërkesat e shëndetit të kafshëve të zbatueshme për lëvizjen jotregtare të kafshëve të shoqërimit dhe rregullat për kontrollet e pajtueshmërisë për një lëvizje të tillë të përcaktuar në këtë rregullore.

2. SPV ofron informacionin e përmendur në pikën 1 në website-n e Ministrisë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj

SHTOJCA I

Llojet e kafshëve shtëpiake

PJESA A

Qentë (*Canis lupus familiaris*)

Macet (*Felis silvestris catus*)

Nuselalat (*Mustela putorius furo*)

PJESA B

Jovertebrorët (me përjashtim të bletëve dhe bletëve pjalmuese dhe molusqeve që i përkasin Familjes *Mollusca* dhe krustaceve që i përkasin nënklasës *Crustacea*;

Kafshët ujore zbukuruese të cilat mbahen, rriten ose vendosen në treg vetëm për qëllime zbukurimi.

Amfibët

Zvarranikët

Zogjtë: lloje të specieve të shpendëve, përveç gjelave, gjelave të detit, shpendëve guinea, rosave, patave, thëllëzave, pëllumbave, fazanëve, thëllëzave dhe struçt (*Ratitae*) të rritura ose të mbajtura në kafaze për shumim, prodhimin e mishit ose vezëve për konsum, ose për rimbushjen e rezervateve për gjueti.

Gjitarët: brejtës dhe lepuj të ndryshëm nga ata të destinuar për prodhimin e ushqimit të përcaktuar nën “lagomorfet”.

SHTOJCA II

Kërkesat teknike për transponderët

Transponderët, duhet:

a) të jetë në përputhje me standardin ISO 11784 dhe të zbatojë teknologjinë HDX ose FDX-B; dhe

b) të jetë në gjendje të lexohet nga një pajisje leximi në përputhje me standardin ISO 11785.

Mikroçipi përmban numrin unik 15-shifror si vijon:

- tri shifrat e para tregojnë kodin e shtetit – 008, në përputhje me standardin EN ISO 3166;
- shifra e katërt është zero;
- shifrat e pesta dhe të gjashta merren duke zbritur nga numri 991 i kodit të prodhuesit të mikroçipit, të përcaktuar nga standardet ICAR të Komitetit Ndërkombëtar për Regjistrimin e Kafshëve; dhe

- shifrat e fundit, nga shifra e shtatë deri në të 15-n, përcaktojnë numrin unik të identifikimit të kafshës.

SHTOJCA III

Kërkesat e vlefshmërisë për vaksinat kundër tërbimit

1. Vaksina kundër tërbimit duhet:

a) të jetë një vaksinë e ndryshme nga një vaksinë e modifikuar e gjallë dhe të jetë në një nga kategoritë e mëposhtme:

i) një vaksinë e inaktivizuar me të paktën një njësi antigjenike për dozë (rekomandim nga Organizata Botërore e Shëndetësisë); ose

ii) një vaksinë rekombinante që shpreh glikoproteinën imunizuese të virusit të tërbimit në një vektor virusi të gjallë;

b) kur administrohet në Republikën e Shqipërisë, duhet t'i jetë dhënë një autorizim tregtimi në përputhje me ligjin për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë;

c) kur administrohet nga një vend tjetër, i është dhënë një miratim ose licencë nga autoriteti kompetent dhe plotëson të paktën kërkesat e përcaktuara në pjesën përkatëse të kapitullit në lidhje me tërbimin në Manualin e Testeve Diagnostike dhe Vaksinave për Kafshët Tokësore të Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve.

2. Vaksinimi kundër tërbimit duhet të plotësojë këto kushte:

a) vaksina është administruar nga një veteriner privat/autorizuar;

b) kafsha e shoqërimit ka qenë të paktën 12 javë nga data në të cilën është administruar vaksina;

c) data e administrimit të vaksinës tregohet nga një veteriner privat/autorizuar ose një veteriner zyrtar në seksionin përkatës të dokumentit të identifikimit;

d) data e administrimit e përmendur në pikën (c) nuk i paraprin datës së aplikimit të transponderit ose tatuazhit ose datës së leximit të transponderit ose tatuazhit të treguar në seksionin përkatës të dokumentit të identifikimit;

e) periudha e vlefshmërisë së vaksinimit fillon nga vendosja e imunitetit mbrojtës, e cila nuk duhet të jetë më pak se 21 ditë nga përfundimi i protokollit të vaksinimit të kërkuar nga prodhuesi për vaksinimin parësor dhe vazhdon deri në përfundimin e periudhës së imunitetit mbrojtës, siç përcaktohet në specifikimin teknik të autorizimit të tregtimit të përmendur në pikën 1 (b) ose miratimin ose licencën e përmendur në pikën 1(c) për vaksinën kundër tërbimit në vendin ku administrohet vaksina.

Periudha e vlefshmërisë së vaksinimit shënohet nga një veteriner i autorizuar ose një veteriner zyrtar në seksionin përkatës të dokumentit të identifikimit;

a) një rivaksinim duhet të konsiderohet një vaksinim parësor nëse nuk është kryer brenda periudhës së vlefshmërisë të përmendur në pikën (e) të vaksinimit të mëparshëm.

SHTOJCA IV

Kërkesat e vlefshmërisë për testin e titrimit të antittrupave të tërbimit

1. Marrja e mostrës së gjakut e nevojshme për kryerjen e testit të titrimit të antittrupave të tërbimit duhet të kryhet dhe dokumentohet nga një veteriner privat/ autorizuar në seksionin përkatës të dokumentit të identifikimit;

2. Testi i titrimit të antittrupave të tërbimit:

a) duhet të kryhet nga një kampion të marrë të paktën 30 ditë pas datës së vaksinimit dhe:

i) jo më pak se tre muaj përpara datës së:

- lëvizjes jotregtare nga një vend i ndryshëm nga ato të listuara në aktet zbatuese të miratuara në përputhje me nenin 9 pika 1 ose 2; ose

- tranzitit përmes një territori të tillë të një vendi, ku nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën (c) të nenit 12, ose

ii) përpara se kafsha e shoqërimit të largohet nga Republika e Shqipërisë për lëvizje ose tranzit përmes një territori të një vendi të ndryshëm nga ato të listuara në përputhje me nenin 9 pika 1 ose

2. Dokumenti i identifikimit në formatin e parashikuar në nenin 15 pika 1 duhet të konfirmojë që një test titrimi i antittrupave të tërbimit është kryer me një rezultat të favorshëm përpara datës së lëvizjes;

b) duhet të matë një nivel të antittrupave neutralizues ndaj virusit të tërbimit në serum të barabartë ose më të madh se 0,5 IU/ml dhe duke përdorur një metodë të përshkruar në pjesën përkatëse të Kapitullit në lidhje me tërbimin në Manualin e Testeve Diagnostike dhe Vaksinave për Kafshët Tokësore të Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve;

c) duhet të kryhet në një laborator të miratuar në përputhje me kriteret e nevojshme për standardizimin e testeve serologjike për të monitoruar efektivitetin e vaksinave të tërbimit;

d) nuk duhet të ribërë pas një rezultati të kënaqshëm të përshkruar në pikën (b), me kusht që kafsha shtëpiake të rivaksinohet brenda periudhës së vlefshmërisë të përmendur në pikën 2(c) të shtojcës III të vaksinimit të mëparshëm.

SHTOJCA V

DEKLARATA

KËRKESAT PËR FORMATIN, PARAQITJEN DHE GJUHËN E DEKLARATAVE TË PËRMENDURA NË NENIN 7 PIKA 2 DHE NË PIKËN (C) TË NENIT 8 PIKA 1 TË KËSAJ RREGULLOREJE

PJESA I

FORMATI DHE FAQOSJA E DEKLARATËS SË PËRMENDUR NË NENIN 7 PIKA 2 TË KËTIJ URDHRI

DEKLARATA

Unë i nënshkruari..... pronari ose personi fizik që ka autorizim me shkrim nga pronari për të kryer lëvizjen jokomerciale të kafshëve shtëpiake në emër të pronarit (2)].

Deklaroni se që nga lindja deri në kohën e lëvizjes jo-tregtare, kafshët e shoqërimit të mëposhtme nuk kanë pasur kontakt me kafshë të egra të specieve të ndjeshme ndaj tërbimit:

Transponder/tatuazh ⁽²⁾ Kodi alfanumerik	Pasaporta/ Numri i certifikatës shëndetësore të kafshëve

Vendi dhe data

Firma

(1) /Të plotësohet me shkronja të mëdha

(2) /fshije sipas rastit.

* Deklarata hartohet në gjuhën shqipe dhe angleze dhe plotësohet me shkronja të mëdha.

PJESA 2

FORMATI DHE FAQOSJA E DEKLARATËS SË PËRMENDUR NË PIKËN (C) TË NENIT 8 PIKA 1, TË KËSAJ RREGULLOREJE

DEKLARATA

Unë i nënshkruari..... pronari ose personi fizik që ka autorizim me shkrim nga pronari për të kryer lëvizjen jokomerciale të kafshëve shtëpiake në emër të pronarit (2)],

Deklaroni se gjatë kalimit tranzit përmes një prej territoreve ose vendeve të ndryshme nga ato të renditura në Aneksin III të Librit të Rregullave për Kërkesat për lëvizjen jokomerciale të kafshëve të shoqërimit, kafshët e shoqërimit të mëposhtme nuk kanë pasur kontakt me kafshë të specieve të ndjeshme ndaj tërbimit dhe qëndrojnë të sigurt brenda një mjeti transporti ose brenda perimetrit të një aeroporti ndërkombëtar (2):

Transponder/tatuazh ⁽²⁾ Kodi alfanumerik	Pasaporta/ Numri i certifikatës shëndetësore të kafshëve

Vendi dhe data

Firma

(1) /Të plotësohet me shkronja të mëdha

(2) /fshije sipas rastit.

* Deklarata hartohet në gjuhën shqipe dhe angleze dhe plotësohet me shkronja të mëdha.

SHTOJCA VI

LISTA E VENDEVE TË PËRMENDURA NË NENIN 9 TË KËTIJ URDHRI

PJESA 1

LISTA E VENDEVE TË BE-SË TË PËRMENDURA NË NENIN 9 (1)

Kodi ISO	Vendet e BE
AT	Austri
BE	Belgjikë
BG	Bullgari
CY	Qipro
CZ	Republika Çeke
DE	Gjermani
DK	Danimark
EE	Estoni
EL	Greqi
ES	Spanjë
FI	Finland
FR	Francë
HR	Kroaci
HU	Hungari
IE	Irland
IT	Itali
LT	Lituani
LU	Luksemburg
LV	Letoni
MT	Maltë
NL	Hollandë
PL	Poloni
PT	Portugali
RO	Rumani
SE	Suedi
SI	Slloveni
SK	Sllovaki

Shtetet EFTA

Kodi ISO	Vendet
AD	Andorra
CH	Zvicër
FO	Ishujt Faroe
GI	Gjilbraltar
GL	Greenland
IS	Island
LI	Lichtenstein
MC	Monako
NO	Norvegji
SM	San Marino
VA	Vatikan

LISTA E TERRITOREVE DHE VENDEVE TË PËRMENDURA NË NENIN 9 (2)

Kodi ISO	Vendi/territori	Territoret e përfshira
AC	Ishulli Ascension	
AE	Emirates e Bashkuara Arabe	
AG	Antigua dhe Barbuda	
AR	Argjentina	
AU	Australia	
AW	Aruba	
BA	Bosnia dhe Herzegovina	
BB	Barbados	
BH	Bahrain	
BM	Bermuda	
BQ	Bonaire, Sint Eustatius and Saba (the BES Islands)	
BY	Bjellorusi	
CA	Kanada	
CL	Kili	
CW	Curaçao	
FJ	Fiji	
FK	Ishujt Falkland	
GB	Mbretëri e Bashkuar	
GG	Guernsey	
HK	Hong Kong	
IM	Ishulli i Njeriut	
JM	Xhamaika	
JP	Japoni	
JE	Xhersi	
KN	Shën Kitts dhe Nevis	
KY	Ishujt Kajman	
LC	Santa Lucia	
MS	Montserrat	
MK	Maqedonia e Veriut	
MU	Mauritius	
MX	Meksikë	
MY	Malajzia	
NC	Kaledonia e Re	
NZ	Zelanda e Re	
PF	Polinezia Franceze	
PM	Shën Pierre dhe Miquelon	
RU	Rusi	

SG	Singapor	
SH	Shën Helena	
SX	Sint Maarten	
TT	Trinidad dhe Tobago	
TW	Taivan	
US	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	AS – American Samoa GU – Guam MP – Northern Mariana Islands PR – Puerto Rico VI – US Virgin Islands
VC	Saint Vincent dhe Grenadines	
VG	Ishujt e Virgjër Britanik	
VU	Vanuatu	
WF	Wallis and Futuna	

SHTOJCA VII

PJESA I

PASAPORTA


REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Republika e Shqipërisë

**PASAPORTË PËR
KAFSHËT E
SHOQËRIMIT**

Kodi ISO i Shtetit + numri

I. Details of ownership/ Detajet e pronësisë
1. Name/ Emri: _____ Surname/ Mbiemri _____ Address/ Adresa _____ _____ Post-Code/ Kodi postar _____ City/ Qyteti _____ Country/ Shteti _____ Telephone number/ Nr. Tel _____ Signature/ Firma _____
2. Name/ Emri _____ Surname/ Mbiemri _____ Address/ Adresa _____ _____ Post-Code/ Kodi Postar _____ City/ Qyteti _____ Country/ Shteti _____ Telephone number/ Nr. Tel _____ Signature/ Firma _____ * optional/ opsionale
ISO Country Code + number/ Kodi ISO i shtetit + numri

II. Description of animal/ Përshkrimi i kafshës
Picture of animal (optional)/ Foto e kafshës (opsionale)
1. Name/ Emri _____ 2. Species/ Specia _____ 3. Breed/ Rraca _____ 4. Sex/ Seksi _____ 5. Date of birth/ Datëlindja _____ 6. Colour/ Ngjyra _____ 7. Any notable or discernable features or characteristics/ Çdo veçori ose karakteristika e dukshme ose e dallueshme _____ * as stated by owner/ sic thuhet nga pronari ISO country code + number Kodi ISO i shtetit + numri

III. MARKING OF ANIMAL/ IDENTIFIKIMI I KAFSHËVE
1. Transponder alphanumeric code/ Kodi alfanumerik i Transponderit _____
2. Date of application or reading* of the transponder/ Data e aplikimit ose leximit* të transponderit _____
3. Location of the transponder/ Vëndodhja e transponderit _____
4. Tatoo alphanumeric code/ Kodi alfanumerik i tatuazhit _____
5. Date of application/ date of reading of the tatoo/ Data e aplikimit/ data e leximit të tatuazhit _____ / _____
6. Location of the tatoo/ Vëndodhja e tatuazhit _____
The marking must be verified before any new entry is made on this passport / Identifikimi duhet të verifikohet para se të bëhet një hyrje e re në këtë pasaportë
* delete as necessary/ *fshijeni nëse është e nevojshme
ISO Country code + Number/ Kodi ISO i Shtetit + Numri

IV. ISSUING OF THE PASSPORT/ LËSHIMI I PASAPORTËS
Name of private/authorized veterinarian/ Emri i Veterinarit privat/ të autorizuar _____
Address/ Adresa _____
Post - Code/ Kodi postar _____
City/ Qyteti _____
Country/ Shteti _____
Telephone number/ Nr. tel _____
E-mail address/ Adresa e-mail _____
Date of issuing/ Data e lëshimit _____
STAMP & SIGNATURE VULA & FIRMA
ISO Country Code + Number/ Kodi ISO i Shtetit + Numri

V. VACCINATION AGAINST RABIES/ VAKSINIMI KUNDËR TËRBIMIT

MANUFACTURER & NAME OF VACCINE/ PRODHUESI DHE EMRI I VAKSINËS

BATCH NUMBER/ NUMRI I SERISË

VACCINATION DATE (1) / DATA E VAKSINIMIT (1)
VALID FROM (2) / E / VLEPSHME NGA DATA (2)
VALID UNTIL (3) / E / VLEPSHME DERI MË (3)

PRIVATE / AUTHORISED VETERINARIAN / VETERINERI PRIVAT / I AUTORIZUAR

ISO Country Code + Number

1

2

3



1

2

3



* At least name, address, telephone number and signature/ * Të paktën emri, adresën, Nr. tel dhe firmën

ISO Country Code + Number

1

2

3



1

2

3



1

2

3



* At least name, address, telephone number and signature/ * Të paktën emri, adresën, Nr. tel dhe firmën

VI. RABIES ANTIBODY TITRATION TEST/ TESTI I TITRIMIT TË ANTITRUPAVE TË TËRRIMIT	
